



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3511/6 prot.

Datë 10.12.2024

V E N D I M
Nr. 1752/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.12.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Shehu” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-25985-10-23-2024, me objekt: “*Rrethim i ambjenteve te fushes se futbollit te qytetit te Bulqiz*”, me fond limit 8,943,326.51 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë BOE “2 L&M + LIQENI VII” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Shehu” SHPK me Nipt J66702707S me adresë: Ndërtesa 1-katëshe, me zonë kadastrale nr. 2592 dhe me nr. Pasurie 440, në rrugën nacionale Peshkopi, Dibër.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Bulqizë.
Adresa: Lagja Minatori.

Subjekt i interesuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE “2 L&M + LIQENI VII” SHPK me NIPT L61417032P dhe L61417032P, me adresë: Paskuqan 1, Rruga Hoxha Tasim, Vila Kalia, ZK 3993, pasuria nr.314/10, Tiranë, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.10.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-25985-10-23-2024, me objekt: “*Rrethim i ambjenteve te fushes se futbollit te qytetit te Bulqizes*”, me fond limit 8,943,326.51 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

II.2. Në datën 04.11.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt- ankimi.

II.3. Në datën 08.11.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE 2 L&M + LIQENI VII	8 110 856 lekë	Kualifikuar
2. Shehu SHPK	8 302 099 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 21.11.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Njoftim fituesi paraprak” për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Operatori ekonomik “Shehu” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi me arsyen se: “*Nuk permbush kriterin 2.3.6 pasi Inxhinieria e Ndertimit Ana GJINI eshte e angazhuar ne nje kontrate tjeter, Operatori Ekonomik ka nje kontrate te lidhur me Bashkine Bulqize te paperfunduar me objekt “Mirembajtje e Kanaleve Ujitese dhe Vaditese per Njesite Administrative, Bashkia Bulqize Viti 2024”*”, ku drejtues Teknik eshte deklaruar Znj. Ana Gjini dhe eshte deklaruar qe do te jete e pranishme gjate gjithe kohes se punimeve ne objekt.. 2 Nuk permbush kriterin 2.3.11 pasi nje pjese e makinerive te deklaruar qe do te angazhohen dhe qe nuk jane deklaruar ne ndonje kontrate tjeter rezultojne te jene deklaruar ne prokurimin me objekt “*Mirembajtje e Kanaleve Ujitese dhe Vaditese per Njesite Administrative, Bashkia Bulqize Viti 2024*”, ku operatori ekonomik eshte shpallur fitues dhe ka nje kontrate te paperfunduar me Bashkine Bulqize. Nga situacioni NR.1 i punimeve te paraqitur nga Operatori Ekonomik rezulton qe keto makineri jane akoma te nevojshme per kryerjen e punimeve ne objek”.

II.6. Në datën 27.11.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. ankimi elektronik A/2024/4846 dhe me nr. 3511/2024 prot, datë 02.12.2024 e operatorit ekonomik “Shehu” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Shehu” SHPK dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE “2 L&M + LIQENI VII” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt,

numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 3511/2 prot., datë 02.12.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Shehu” SHPK, si dhe lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE “2 L&M + LIQENI VII” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorë ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në lidhje me ankimimin e bërë nga ana e OE “Shehu” SHPK.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 6006 prot., datë 05.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 3511/3 prot., datë 10.12.2024 me objekt “*Dërgim vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës (nr. 1, datë 05.12.2024) rezulton se ky i fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Shehu” SHPK”, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se:

“Nuk përmbush kriterin 2.3.6 pasi Inxhinieria e Ndertimit Ana GJINI eshte e angazhuar ne nje kontrate tjeter, Operatori Ekonomik ka nje kontrate te lidhur me Bashkine Bulqize te paperfunduar me objekt “Mirembajtje e Kanaleve Ujitesë dhe Vaditese per Njesite Administrative, Bashkia Bulqize Viti 2024””, ku drejtues Teknik eshte deklaruar Znj. Ana Gjini dhe eshte deklaruar qe do te jete e pranishme gjate gjithe kohes se punimeve ne objekt”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.6 “*Kapaciteti teknik*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.6. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, **te përfshirë ne licensen e shoqërisë**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- Inxhinier ndertimi 1(nje)

III.1.2. Në shtojcën 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	----- ---
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -----
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT-i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime</i> <i>nëse</i> <i>vlerësohet</i> <i>e</i> <i>nevojshme</i></p> <p>_____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime</i> <i>nëse</i> <i>vlerësohet</i> <i>e</i> <i>nevojshme</i></p> <p>_____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime *nëse* *vlerësohet* *e* *nevojshme*

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime *nëse* *vlerësohet* *e* *nevojshme*

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime *nëse* *vlerësohet* *e* *nevojshme*

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime *nëse* *vlerësohet* *e* *nevojshme*

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime *nëse* *vlerësohet* *e* *nevojshme*

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

<p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <hr/>

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

<p>Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:</p> <p>Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.</p>

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e

nevojshme_____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e	Punonjës Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve

<p>vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p>Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:</p> <p>1. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>2. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>3. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>
---	--

C: DEKLARATË

“Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen

ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

Kontratë furnizimi				
Materiali/pro dukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,

etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.**
- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**
- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik animues “Shehu”SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Shehu” SHPK.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet*

procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.5. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë

kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.9. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi.

Referuar arsytimit të autoritetit kontraktor rezulton se operatori ekonomik “Shehu” SHPK është skualifikuar për mospërbushje të kërkesës për staf inxhinierik, sipas pikës 2.3.6, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, me arsyen se: *Inxhinieria e Ndërtimit A.GJ është e angazhuar në një kontratë tjetër, Operatori Ekonomik ka një kontratë të lidhur me Bashkinë Bulqizë të papërfunduar me objekt “Mirëmbajtje e Kanaleve Ujitëse dhe Vaditëse për Njësitë Administrative, Bashkia Bulqizë Viti 2024”, ku drejtues Teknik është deklaruar Znj. A.GJ dhe është deklaruar që do të jetë e pranishme gjatë gjithë kohës së punimeve në objekt.*

Referuar dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.6 ka përcaktuar se: *Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licënsen e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht: Inxhinier ndertimi 1(nje), Pikat 2.3.6, 2.3.7 dhe 2.3.8 konsiderohen te permbushur me paraqitjen e formularit te vetedeklarimit sipas shtojces 8.*

Në rastin konkret operatori ekonomik “Shehu” SHPK”, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar: Formularin përmbledhës të vetedeklarimit, ku në Pjesën e III: Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate” ka deklaruar punonjësit e nevojshëm, siç përcaktohet në dokumentat e tenderit, ku Znj. A.GJ është deklaruar në funksion të inxhinieres së ndërtimit, pra kriterit 2.3.6.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vedeklarimit nuk konstatohet që të ketë rubrikë për deklarimin e mosangazhimit të inxhinierit të ndërtimit në ndonjë kontratë tjetër sikurse pretendohet nga autoriteti kontraktor.

Në rastin konkret, Komisioni vlerëson se, referuar kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik deklarimi i bërë nga operatori ekonomik ankimues në formularin përmbledhës, në Pjesën e III: Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate” staf teknik dhe punonjës të specializuar/të kualifikuar lidhur me stafin inxhinierik “Ing ndërtimi” çon në përmbushje të kriterit të kërkuar.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në kushtet e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e

tenderit objekt – ankimi, sa i takon kërkesës për staf teknik dhe punonjës të specializuar/të kualifikuar për *Inxhinier ndërtimi 1(një)*.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Shehu” SHPK”, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se:

“- Nuk përmbush kriterin 2.3.11 pasi një pjesë e makinerive të deklaruar që do të angazhohen dhe që nuk janë deklaruar në ndonjë kontratë tjetër rezultojnë të jenë deklaruar në prokurimin me objekt ““Mirëmbajtje e Kanaleve Ujitëse dhe Vaditëse për Njësitë Administrative, Bashkia Bulqizë Viti 2024”, ku operatori ekonomik është shkallur fitues dhe ka një kontratë të papërfunduar me Bashkinë Bulqizë. Nga situacioni NR.1 i punimeve të paraqitur nga Operatori Ekonomik rezulton që këto makineri janë akoma të nevojshme për kryerjen e punimeve në objekt”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.11 “*Kapaciteti teknik*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.11 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e konkretisht:

Deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik,qe nevojitet per ekzekutimin e kontrates.

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minimumi
•	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 12 ton	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Kamionçine kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Fadrome me gome ose grejder	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Autovinc ose kamion me vinç	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Rrul ngjeshes me vibrim	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Vibrator betoni	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Eskavator me goma ose me zinxhir	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Matrapik	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Autobot uji	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Depozite uji 2000 litra	Ne pronesi ose me qira	1 cope
•	Autobetoniere	Ne pronesi ose me qira	1 cope

•	Betoniere 0.5 m3	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Elektro ose motosaldatriçe	Ne pronesi ose me qira	2 cope
•	Gazogjen	Ne pronesi ose me qira	1 cope

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar për punetoret e mesiperm.

- a) Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjeti (te vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronesise se mjetit.
- b) Per mjetet e siguruar me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leja e qarkullimit) plus çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjeti (te vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronesise se mjetit si dhe duhet te shoqerohen me kontraten perkatese noteriale te qerese ,evlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) **Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kopetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit ,ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.**
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë ne çdo kohe deri ne perfundimin e kontrates mjetet e pajisjet teknik
- e) **Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera, (Deklarate nga Administratori I Shoqerise Ofertuese).**

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Shehu” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formular përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Shehu” SHPK.
- Deklaratë nga administratori i shoqërisë.

III.2.4. Referuar arsytimit të autoritetit kontraktor rezulton se operatori ekonomik ankimues “Shehu” SHPK, është skualifikuar me arsyen se: *Nuk përmbush kriterin 2.3.11 pasi një pjesë e makinerive të deklaruara që do të angazhohen dhe që nuk janë deklaruar në ndonjë kontratë tjetër rezultojnë të jenë deklaruar në prokurimin me objekt “Mirëmbajtje e Kanaleve Ujitëse dhe Vaditëse për Njësitë Administrative, Bashkia Bulqizë Viti 2024”, ku operatori ekonomik është shkallur fitues dhe ka një kontratë të papërfunduar me Bashkinë Bulqizë. Nga situacioni NR.1 i punimeve të paraqitur nga Operatori Ekonomik rezulton që këto makineri janë akoma të nevojshme për kryerjen e punimeve në objekt.”.*

Referuar kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.11 të kapacitetit teknik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në këtë pikë ka përcaktuar makineritë e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës. Autoriteti kontraktor, ndër të tjera lidhur me këtë kriter, ka përcaktuar se nga ana e administratorit të shoqërisë duhet të paraqitet një deklaratë, në të cilën të deklarojë se makineritë nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera.

Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Shehu” SHPK, ka dorëzuar Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku në Pjesën e III: Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt - kontrate” ka deklaruar makineritë si më poshtë vijon:

Rrethim i ambienteve të fushës së futbollit të qytetit të Bulqizës “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si më poshtë:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Leja qilimit	Nr. Shtetit	Të tjera
Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 12 ton	AB 338 MH	PE000496323	V	
Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 12 ton	AB 487 CO	PE000061821	V	602
Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 12ton	AG 831	PE000282521		
Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5 ton	AA 884 DH	PE01014312		



Shfaqet dhe Formularët 15

Fadrone	ADMT 06			
Autovinc ose Kamion me vinc	AA 087 CZ	PE		767
Rrui ngjeshës me vibrim	Fature Blerje TVSH			4
Vibrator betoni	Fature tvsh			Cup 2
Eskavator me goma	Fature cdoganimi			64
Matrapik	Fature Blerje			4
Autobot Uji	AA025TR	EU0		38
Depozita Uji	Fature Blerje TVSH			75
Autobetonjete	AB 261 AL			
Betoniere	Fature Blerje TVSH			ip 2
Elektro ose Motosaldrice	Fature cdoganimi	Nr.1204 Date 02.11.2018	0792452392	
GAZOGJEN	Fature cdoganimi	Nr.1204 Date 02.11.2018	0792452392	

Elektro ose Motosaldaricie	Fatura cdoganimi	02.11.2024
GAZOGJEN	Fatura cdoganimi	02.11.2024

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targemjeti	Nr. Laps qarkullimi mjeti	Nr. Shasësë mjetit	Nr. Kont të qerast	Allet i kontratës qerastit dhe fillimit dhe mbarimit
Mercedes Benz	AA 014 IP	HEV00100057		147 date 07.08.2024	07.08.2024-07.08.2026



Shtojca dhe Formulari 16

Kontrate furnizimi

Si dhe deklaratën e administratorit se makineritë e deklaruara sipas kërkesave në DST dhe deklaratimet e bëra në Formularin e vetëdeklarimit nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Komisioni konstaton se në ankesë operatori ekonomik ankimes lidhur me arsyen e skualifikimit sa i takon kriterit 2.3.11 pretendon ndër të tjera se : *Une si operatore ekonomik pjesemarrës në këtë procedurë prokurimi kam deklaruar mjetet me targë AB338MH I cili është kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 10 ton, mjetin me targë AA025TR I cili është deklaruar Autobot uji, Mjetin me targë AA884DH I cili është kamiocine me kapacitet mbajtes 3.5 ton, ku këto mjete janë paraqitur nga ana ime edhe në procedurë e prokurimit me objekt Mirembajtje kanale ujitesë dhe vaditese për Njesite Administrative, bashkia Bulqize, e cila është zhvilluar me datë 08.04.2024 nga ana e Bashkisë Bulqize. Shohim që në procedurën e prokurimit që citova më sipër në lidhje me kanalet vaditese unë kam deklaruar dy Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtes nga 7.5 deri 18 ton, të cilët identifikohen me targë AB338MH dhe AB487CO, të cilat janë për të njëjtin funksion. Me datë 18.10.2024 është bërë nga ana e operatorit ekonomik SHEHU sh.p.k. që disponoj mjetet sipas shtojcës nr.8 (vetëdeklarimi) duke pasur parasysh që janë perfunduar punimet në kontratën që kam me bashkinë bulqize me objekt Mirembajtje kanale ujitesë dhe vaditese për Njesite Administrative, rreth 85 % e volumit të punimeve të mbaruar, ku për realizimin e punimeve të mbetura është e mjaftueshme mjeti me targë AB487CO I cili nuk është pjesë e vetëdeklarimeve në shtojcën nr.8 për procedurë me objekt Rikualifikimi urban i sheshit dhe ndertimi i tezgave bujqesore në lagjen e Re. Për sa i përket mjeteve me targë AA884DH dhe AA025TR, është i njëjti kundërshtim si më lartë që cituam në lidhje me Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtes nga 7.5 deri 18 ton. Ja vlen të theksojmë që operatori ekonomik SHEHU sh.p.k. ka realizuar punët e kontratës me objekt: Mirembajtje kanale ujitesë dhe vaditese për Njesite Administrative, rreth 85 % e volumit të punimeve, ku me mjetet që disponohen sipas formularit të vetëdeklarimit ezaurohen në kohën e duhur nga ana jone...*

Gjithashtu, komisioni konstaton se sa i takon arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, ky i fundit nuk ka bërë një analizë të thelluar nëse mjetet e deklaruara në procedurën me objekt “Mirembajtje kanale ujtesë dhe vaditese për Njësitë Administrative, Bashkia Bulqizë” nga operatori ekonomik ankimues, janë ende të nevojshme apo jo për këtë objekt, në kushtet kur është i njëjti autoritet kontraktor dhe ka gjithë informacionin e nevojshëm për të bërë një verifikim të tillë.

Sa më sipër arsyetuar, referuar dokumentacionit të sipërpërmendur të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, arsyes së skualifikimit të përdorur nga autoriteti kontraktor, si dhe pretendimeve të ngritura nga operatori ekonomik ankimues në ankesë, KPP vlerëson se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, duke vlerësuar edhe njëherë makineritë për të cilat pretendon se janë të angazhuara në procedurën me objekt “Mirembajtje kanale ujtesë dhe vaditese për Njësitë Administrative, Bashkia Bulqizë” pasi të bëjë më parë një analizë të thelluar nëse këto mjete vazhdojnë të jenë ose jo të nevojshme në procedurën e sipërpërmendur

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Shehu”SHPK për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE “2 L&M + LIQENI VII” SHPK me pretendimin se: [...] *Duke u nisur sa më lart kërkojmë që Bashkimi i operatorëve ekonomikë “2 L&M + LIQENI VII” duhet të skualifikohet pasi nuk kanë zbatuar neni 88 Bashkimi i operatorëve ekonomikë.*

1.Ne perqindje Kërkesat për kualifikim

2. Sipas perqindjes kerkesat ekonomike, financiare

3. Sipas perqindjes kerkesat profesionale dhe ato teknike te stafit e Fuqise Punetore

4. Sipas perqindjes te makinetive. kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre

5. Sipas perqindjes te Formularit te ofertes. Sigurimit te Ofertes dhe Oferten e dhene te ndare sipas Perqindjes se deklaruar 15x85%.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP, operatori ekonomik ankimues nuk parashtrohet fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e kriterëve nga bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE “2 L&M + LIQENI VII” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.3.2. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.3.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.3.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kritereve.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikisht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.3.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientësi e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrajnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kritereve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “onus probandi incumbit actori” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.3.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.3.8. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shehu” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-25985-10-23-2024, me objekt: “Rrethim i ambjentëve të fushës së futbollit të qytetit të Bulqiz”, me fond limit 8,943,326.51 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Shehu” SHPK në baze të konstatimeve të shprehura në këtë vendim.

3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shehu” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

